

SHENIMET SHPJEGUESE

• Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "SH.A. Ujësjetllës Kanalizime Lezhë" është e regjistruar shoqëri anonime me vendim të gjykatës të Rrethit Tiranë Nr 24431 dt 26.09.2000. Kapitali i shoqërisë është 498,357,489 lekë me NIPT: J68007501M

Shoqëria ka si objekt të saj kryesor; **Prodhim e shitje uji të pijshëm, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Grumbullimi, trajtimi dhe largimi i ujrave të ndotura dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura si dhe të impiantit të pastrimit të tyre.**

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 144 punonjës, (31 dhjetor 2019; 143 punonjës).

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

• Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin dhe ligjin nr.25/18, date 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të bazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese

të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

• Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të

7 | Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri në faqen 19 janë pjese perberese e pasqyrave financiare

ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huat e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huat e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesat e instalime	Vlera mbetur	5%
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %

9 | Shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në faqen 19 janë pjese perberese e pasqyrave financiare

Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike.

Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivet**1. Aktive monetare**

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2020 eshte ne shumen 98,998,963 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Depozita ne banke	98,998,963	126,297,804
2	Para ne arke	-	-
	Totali	<u>98,998,963</u>	<u>126,297,804</u>

E detajuar sipas bankave gjendja e tyre me 31.12.2020 paraqitet si me poshte:

Nr	Banka	Gjendje ne leke me 31.12.2020	Gjendje ne leke me 31.12.2019
1	Raiffeissen Bank	98,998,963	126,297,804
	Shuma	<u>98,998,963</u>	<u>126,297,804</u>

Per konvertimin e monedhave te huaja eshte marre kursi i dates 31.12.2020 i Bankes se Shqiperise, diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2. Te drejta te arketueshme

Ne kete post paraqiten te drejta te arketueshme te shoqerise me 31.12.2020 ne shumen 360,663,867 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Klient nga aktiviteti i shfrytezimit	332,492,582	322,925,850
2	Klient per Taksat Bashkiake	28,171,285	-
3	Tatime Taksa(Kerkesa Tatim Fitimi)	-	420,482
	Totali	<u>360,663,867</u>	<u>323,346,332</u>

2.1 Kliente nga aktiviteti I shfrytezimit

Ne kete post shoqeria ka paraqitur kerkesat ndaj klienteve me 31.12.2020 ne shumen 332,492,582 leke, per te cilet tabela e meposhtme jep informacion me te detajuar:

Nr	Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	Viti 2020	Viti 2019
1	Klient per furnizimin me uje te pishem	345,017,367	334,537,703
2	Zhvleresim I te drejtave te arketueshme	(13,200,000)	(12,200,000)
3	Klient per lidhje te reja	675,215	588,147
	Totali	<u>332,492,582</u>	<u>322,925,850</u>

2.2 Klient per Taksat Bashkiake

Ne kete post shoqeria ka paraqitur kerkesat ndaj klienteve per taksat bashkiake, sipas marreveshjes se lidhur me Bashkine Lezhe, me 31.12.2020 ne shumen 28,171,285 leke.

2.3 Tatime e Taksa

Shoqeria per vitin e mbyllur me 31.12.2020 nuk paraqitet me kerkese ndaj tatimeve.

3. Inventaret

Gjendja e inventarit te dhe materialeve dhe inventarit te imet me 31.12.2020 eshte 7,037,775 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Materiale	5,305,845	4,836,502
2	Inventar I imet	1,731,930	1,772,815
	Totali	<u>7,037,775</u>	<u>6,609,317</u>

- ❖ Vleresimi i mallrave ne momentin e blerjes eshte bere me koston e hyrjes veprimet e daljes e te gjendjeve te inventarit jane bere me kosto mesatare e cila nuk ka ndryshuar ne vite.
- ❖ Te gjitha transaksionet e kryera si blerje, shitje, kalim ne llogarite e shpenzimeve vjetore i perkasin ushtrimit kontabel te vitit 2020.

4. Aktive afatgjata materiale

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019. Gjendja e aktiveve me 31.12.2020 eshte 3,488,131,372 leke, sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Emertimi	Truall dhe ndertese	Mjete transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
I	Aktive afat gjata materiale					
1	Gjendja me 31.12.2019	189,596,272	54,113,900	4,593,311,320	6,691,925	4,843,713,417
2	Shtesat per 2020	-	-	6,188,300	1,368,036	7,556,336
3	Paksimet per 2020	-	-	-	(474,793)	(474,793)
4	Gjendja me 31.12.2020	<u>189,596,272</u>	<u>54,113,900</u>	<u>4,599,499,620</u>	<u>7,585,168</u>	<u>4,850,794,960</u>
II	Amortizimi I AQT-ve					
1	Gjendja me 31.12.2019	59,626,926	22,241,181	1,054,693,498	4,978,871	1,141,540,476
2	Shtesat per 2020	6,171,635	6,374,544	208,450,657	541,074	221,537,911
3	Paksimet per 2020	-	-	-	(414,799)	(414,799)
4	Gjendja me 31.12.2020	<u>65,798,562</u>	<u>28,615,725</u>	<u>1,263,144,155</u>	<u>5,105,146</u>	<u>1,362,663,588</u>
III	Vlera neto 31.12.2020	<u>123,797,710</u>	<u>25,498,175</u>	<u>3,336,355,465</u>	<u>2,480,022</u>	<u>3,488,131,372</u>

Shoqeria me VKM nr 63 dt 27.01.2016 ka mare ne pronesi dhe ne administrim ujesjellsin e komunave, ka rregjistruar ne kontabilitet vlerat e ketyre objekteve dhe eshte ne proces per saktesimin e truallit te tyre.

Bilanci kontabel, pasivet Detyrimet Afatshkurtra

5. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqiten gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2020 ne shumen 107,601,434 leke, si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Kredi afatshkurtera	65,599,588	4,488,370
2	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5,682,674	3,293,612
3	Te pagueshme ndaj Bashkise Lezhe	31,443,316	2,615,600

4	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	1,409,795	1,358,074
5	Te pagueshme per detyrime tatimore	3,466,061	1,371,973
	Shuma	<u>107,601,434</u>	<u>13,127,629</u>

5.1 Kredi afatshkurtra

Paraqitet gjendja e kredive afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2020 ne shumen 65,599,588 leke. E detajuar paraqitet sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Kredi afatshkurtra	Viti 2020		Viti 2019	
		leke	monedhe	leke	monedhe
1	Kredia IDA	23,203,372	\$ 230,101.00	-	-
2	Kredia BEI	27,663,793	€ 223,636.00	-	-
3	Kredia KFV	-	-	-	-
4	Interesa te maturuara	-	-	4,488,370	-
5	Penalitete per mos likuidim ne afat	14,732,423	€ 119,098.00	-	-
	Shuma	<u>65,599,588</u>	<u>-</u>	<u>4,488,370</u>	<u>-</u>

5.2 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Gjendja e furnitoreve te palikujduar eshte 5,682,674leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2020 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve. Lista e furnitoreve paraqitet si me poshte :

Nr	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	Viti 2020	Viti 2019
1	FSHU	5,568,649	3,199,304
2	Furnitore te tjere	114,025	94,309
	Shuma	<u>5,682,674</u>	<u>3,293,613</u>

5.3 Te pagueshme ndaj Bashkise Lezhe

Paraqitet detyrimi i shoqerise ndaj Bashkise Lezhe, per taskat bashkiake sipas marreveshjes se lidhur, ne shumen 31,443,316 leke, deri me 31.12.2020, e detajuar si me poshte :

Nr	Detyrime ndaj Bashkise Lezhe	Viti 2020	Viti 2019
1	Detyrimi per taksat bashkiake te arketuara nga klientet	3,272,031	2,615,000
2	Detyrimi per taksat bashkiake te pa arketuara nga klientet	28,171,285	-
	Shuma	<u>31,443,316</u>	<u>2,615,000</u>

5.4 Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore

Paraqitet detyrimi i shoqerise me 31.12.2020, per sigurime shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor ne shumen 1,409,795 leke.

5.5 Detyrime tatimore

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj shtetit ne shumen 3,466,062 leke me 31.12.2020, shume e cila eshte e detajuar ne tabelen e meposhtme :

Nr	Te pagueshme per detyrime tatimore muaji dhjetor	Viti 2020	Viti 2019
1	Tatim mbi te ardhurat personale	125,236	107,676
2	Tatim mbi vleren e shtuar	1,143,074	1,257,859
3	Tatim ne burim	6,438	6,438
4	Tatim fitimi	2,191,314	-

14 | Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri ne faqen 19 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Shuma 3,466,062 1,371,973

Detyrimet Afatgjata**6. Kredi afatgjata**

Paraqitet detyrimi afatgjate i shoqerise per kredite e marra, me 31.12.2020 ne shumen 834,356,341 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Kredi afatgjata	834,356,341	941,197,611
	Shuma	<u>834,356,341</u>	<u>941,197,611</u>

Tabela e meposhtme jep informacion per gjendjen e mbetur te detajuar siaps kredive te shoqerise, me 31.12.2020:

Nr	Kredi afatgjata	Viti 2020		Viti 2019	
		leke	monedhe	leke	monedhe
1	Kredia IDA	162,423,609	\$ 1,610,706	216,939,368	\$ 1,996,865
2	Kredia BEI	288,462,732	€ 2,331,954	346,771,243	€ 2,847,756
3	Kredia KFV	383,470,000	€ 3,100,000	377,487,000	€ 3,100,000
	Shuma	<u>834,356,341</u>		<u>941,197,611</u>	

7. Kapitali

Shoqeria ka nje kapital te regjistruar prej 498,357,489 leke, Grupi i kapitaleve te veta eshte shtuar me fitimin e vitit 2020 ne shumen 743,689 leke. Totali i kapitaleve te veta me 31.12.2020 eshte 364,062,698 leke. Struktura dhe ndryshimet per vitin 2020 paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva ligjore	Fitime/humbje te mbartura	Fitim/humbje te vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2019	498,357,489	3,193,968	(140,282,239)	2,049,791	363,319,009
2	Shtesat per 2020	-	-	-	743,689	743,689
3	Pakesimet per 2020	-	-	2,049,791	(2,049,791)	-
	Gjendja me 31.12.2020	<u>498,357,489</u>	<u>3,193,968</u>	<u>(138,232,448)</u>	<u>743,689</u>	<u>364,062,698</u>

Pasqyra e Performances**8. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Ne kete post jane paraqitur te ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor si ujesjelles per vitin 2020 ne shumen 196,584,185leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	184,252,923	195,612,088
2	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	12,331,262	10,203,685
	Shuma	<u>196,584,185</u>	<u>205,815,773</u>

8.1 Te ardhurat nga aktiviteti kryesor

Te ardhurat nga aktiviteti kryesor paraqiten ne shumen 184,252,923, si me poshte:

Nr	Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	Viti 2020	Viti 2019
1	Prodhim shitje uji i pishem, grumbullim i ujrave te ndotura	184,252,923	195,612,088
	Shuma	<u>184,252,923</u>	<u>195,612,088</u>

8.2 Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit paraqiten ne shumen 12,331,262 leke, te cilat jane te detajuara si me poshte:

Nr	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga lidhjet e reja	3,442,599	3,054,277
2	Te ardhura nga kamatat	7,992,410	6,160,697
3	Te ardhura nga komisioni per mbledhjen e taksave te Bashkise	896,253	988,711
	Shuma	<u>12,331,262</u>	<u>10,203,685</u>

9. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Ne kete post paraqiten te ardhurat e tjera te shfrytezimit per vitin 2020, ne shumen 198,737,412 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	198,737,412	171,347,241
	Shuma	<u>198,737,412</u>	<u>171,347,241</u>

Te ardhurat e tjera te shfrytezimit te paraqitura ne kete post nga shoqeria perfaqesojne te ardhurat nga financimet, rimarrje grantesh e tj per vitin 2020, sic paraqitet edhe ne tabelen e meposhtme:

Nr	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	Viti 2020	Viti 2019
1	Financim nga MFE per blerje pompash	6,570,000	-
2	Rimarrje te ardhurash nga te ardhurat e shtyra	191,970,642	171,347,241
3	Dhurate nga GIZ (Tre televizore)	196,770	-
	Shuma	<u>198,737,412</u>	<u>171,347,241</u>

10. Lende e pare dhe materialet te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2020 eshte 10,127,281 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	10,127,281	9,673,337
	Shuma	<u>10,127,281</u>	<u>9,673,337</u>

11. Kostot e punes

Kosto e punes per vitin 2020 eshte ne shumen 67,768,885 leke e detajuar si me poshte:

Nr	Shpenzime te personelit	Viti 2020	Viti 2019
1	Paga dhe shperblime	58,060,087	59,421,571
2	Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetimore	9,708,798	9,728,443
	Shuma	<u>67,768,885</u>	<u>69,150,014</u>

Ne tabelen e meposhtme paraqitet informacion ne lidhje me shumen e shumën e pagave që u jepet për periudhën raportuese anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese si edhe numrin mesatar të

punëmarrësve gjatë periudhës raportuese, të zbërthyer sipas kategorive dhe kostot e personelit në lidhje me periudhën raportuese, të zbërthyer sipas pagave, kostove të sigurimeve shoqërore.

Pershkrimi	Nr punonjesh	Paga bruto	Sigurime	Tatimi mbi page	467/30	Paga Neto
			shoqërore e shendetesore			
Administrata	17	12,083,692	1,351,016	777,357	-	9,955,319
Stacionet e pompave (Barbulloje)	12	4,665,564	523,221	70,162	-	4,072,181
Depo e ujit	13	4,597,327	515,424	33,664	100,814	3,947,425
Brigada e Hidraulikeve	10	3,171,102	356,344	-	-	2,814,758
Ujesjellesi Fshat	9	3,083,588	346,413	15,814	-	2,721,361
Aktivitetet ndihmese	7	2,295,857	257,677	327	-	2,037,853
Aktivitetet ndihmese (Roje zyrash)	5	1,944,252	218,020	27,790	-	1,698,442
Sektori I kanalizimeve	16	6,973,473	781,029	162,447	-	6,029,997
Impianti I perpunimit te ujerave te ndotura	9	4,730,376	529,803	195,766	-	4,004,807
Ujesjellesi Njesia Administrative Zejmen	15	4,971,726	558,935	-	-	4,412,791
Ujesjellesi Njesia Administrative Dajç	8	2,548,554	286,357	-	-	2,262,197
Ujesjellesi Njesia Administrative Kallmet	5	1,626,210	182,794	-	-	1,443,416
Ujesjellesi Njesia Administrative Balldre	10	3,036,414	341,262	-	-	2,695,152
Ujesjellesi Njesia Administrative Blinisht	7	2,276,688	255,908	-	-	2,020,780
Mjekja e UK sh.a. Lezhë	1	41,322	8,736	-	-	32,586
Raport qe paguhet nga punedhenesi		13,942	1,562	-	-	12,380
SHUMA	144	58,060,087	6,514,501	1,283,327	100,814	50,161,445
Kontributi I sig. shoq.qe paguhet nga ujesjellesi		9,708,798	9,708,798	-	-	-
Totali	144	67,768,885	16,223,299	1,283,327	100,814	50,161,445

12. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Eshte llogaritur amortizimi i aseteteve per vitin 2020 sipas normave ligjore ne shumen 221,537,911 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	221,537,911	208,540,284
	Shuma	221,537,911	208,540,284

13. Shpenzime te tjera

Shpenzime te tjera paraqiten shpenzime te shoqërisë per vitin 2020, gjithsej ne shumen 71,625,036 leke dhe jane te detajuara sipas tabelës se meposhteme:

Nr	Shpenzime te tjera te shfrytezimit	Viti 2020	Viti 2019
1	Shperblimi i keshillit mbikqyres	386,280	600,300
2	Udhetime e dieta	101,000	124,500
3	Shpenzime postare dhe telefonike	1,222,486	993,097
4	Komisione bankare	64,500	70,750
5	Energji elektrike e konsumuar	62,608,016	54,345,757
6	Tarifa e ERU-se	709,365	994,100
7	Taksat e bashkise	121,820	138,200
8	Te ndryshme	5,351,575	4,615,778
9	Zhvleresim per kerkesat e arketueshme	1,000,000	1,200,000
10	Vlera neto e aktiveve jashte perdorimit	59,994	932,395
	Shuma	71,625,036	64,014,877

Shpenzimet e ndryshme per vitin 2020, paraqitur gjithsej ne Shumen 5,351,575 leke jane te detajuara si me poshte:

Nr Shpenzime te ndryshme

Viti 2020

17 | Shenimet shprehqese nga faqja 6 deri ne faqen 19 jane pjese perberese e pasqyrave financiare

1	Shperblim per fatekqesi	40,000
2	Tarife antarsimi ne shukalb	140,400
3	Trajnime ne shukalb	126,500
4	Auditim pasqyra financiare	894,000
5	Kontrate energjie	494,788
6	Tarife perdorimi uji	149,761
7	Siguracione asete	166,870
8	Siguracione mjete transporti+ lejet e qarkullimit + kontrolli teknik	810,524
9	Shpenzime per uji	849,015
10	Njofitime ne tv	85,800
11	Covid	128,760
12	Riparime e te ndryshme	1,465,157
	Shuma	<u>5,351,575</u>

14. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime financiare te shoqerise ne shumen 23,734,970leke per vitin 2020, si me poshte :

Nr	Shpenzime financiare	Viti 2020	Viti 2019
1	Interesat e kredive	9,002,547	23,161,219
2	Penalitet e vendosura per mos likuidim kredie ne afat	14,732,423	-
	Shuma	<u>23,734,970</u>	<u>23,161,219</u>

15. Te tjera

Paraqiten te ardhura te tjera te shoqerise ne shumen 3,123,724 leke per vitin 2020, te cilat perfaqesojne te ardhura nga kembimet valutore, si me poshte :

Nr	Te tjera	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga kembimet valutore	3,123,724	-
	Shuma	<u>3,123,724</u>	<u>-</u>

16. Llogaritja e tatimit te fitimit

Llogaritja e rezultatit te shoqerise paraqitet ne menyre te permbledhur ne tabelen e meposhtme. Shoqeria per vitin e mbyllur me 31.12.2020 paraqitet me fitim ne shumen 743,689 leke. Shpenzimet e pazbritshme jane ne shumen 19,383,661 leke dhe tatimi i fitimit te llogaritur nga shoqeria per vitin 2020 eshte ne shumen 2,907,549 leke.

Nr	Llogaritja e rezultatit	Viti 2020
I	Te ardhurat	184,252,923
1	Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	12,331,262
2	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	198,737,412
3	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	<u>395,321,597</u>
	Totali I te ardhurave	
II	Shpenzimet	(10,127,281)
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(67,768,885)
2	Shpenzime te personelit	(221,537,911)
3	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(71,625,036)
4	Shpenzime te tjera te shfrytezimit	

	Totali Ishpenzimeve	<u>(371,059,113)</u>
III	Fitimi bruto nga aktiviteti (I+II)	<u>24,262,484</u>
IV	Shpenzimet dhe te ardhurat financiare	(9,002,547)
1	Shpenzime interesi per kredite	(14,732,423)
2	Penalitetet per kredite	3,123,724
3	Te ardhura nga kembimet valutore	<u>(20,611,246)</u>
	Rezultati financiar	<u>3,651,238</u>
VI	Fitimi bruto pas rezultatit financiar	
	Shpenzime te pazbritshme per llogaritjen e fitimit	1,000,000
	Zhvleresim kerkesave te arketueshme	14,732,423
	Penalitetet per kredite	<u>19,383,661</u>
VII	Fitimi I tatueshem	<u>(2,907,549)</u>
VIII	Tatim fitimi 15%	<u>743,689</u>
IX	Fitimi Neto	

17. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

18. Ngjarje pas datës së Bilancit

Ngjarje pas dates se bilancit eshte situata e krijuar gjate periudhes se fatkeqesise natyrore, e shpallur si pasoje e COVID-19.

Flora GJINI

Shefe e deges së llogarive vjetore dhe inventarizimit
(Hartuesi i pasqyrave financiare)

Flora Gjini

Ing Zef MACI



Sh.A. Ujësjetles Kanalizime

Lezhë

LEZHE